REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË

V E N D I M

Nr.38, datë 20/07/2005

"MBI DISA NDRYSHIME NË BUXHETIN E BASHKISË SË TIRANËS PËR VITIN 2005"

Në mbështetje të ligjit Nr.8652, dt.31/07/2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore", neni 19, pika 9, neni 32, gërma "dh", ligjit Nr.7776, dt.22/12/1993 "Për buxhetin lokal", neni 18, ndryshuar me ligjin Nr.8399, dt.09/09/1998, Udhëzimit Nr.1, dt.26/01/2005 "Për zbatimin e buxhetit të investimeve në arsimin parauniversitar për vitin 2005", paragrafi I, pika 9, Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr.12, dt.21/03/2005 "Për miratimin e realizimit të buxhetit për vitin 2004 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitit 2005", bazuar në kërkesat e Institucioneve të Varësisë, me proprozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I;

1. Të miratojë një shtesë në buxhetin e vitit 2005 të Drejtorisë së Konvikteve të Shkollave të Mesme për "Blerje pajisjesh" në shumën prej 1.090.000 lekësh, sipas Tabelës Nr.1, pjesë përbërëse e këtij Vendimi.

2. Të miratojë një transferim të fondit prej 1.000.000 lekësh për Aparatin e Bashkisë së Tiranës nga zëri "Blerje pajisjesh për zyrat e Bashkisë së Tiranës" në zërin "Blerje pajisje të tjera" sipas Tabelës Nr.2, pjesë përbërëse e këtij Vendimi.

3. Të miratojë një shtesë në buxhetin e vitit 2005 të Drejtorisë së Përgjithshme të Taksave dhe Tarifave Vendore në zërin "Shpenzime operative" në shumën prej 1.000.000 lekësh.

4. Të miratojë fondin e investimeve për vendosjen e sistemit të ngrohjes në shumën 14.068.536 lekë dhe 500.000 lekë per mbikqyrjen e punimeve dhe kolaudimin, në 3 objektet arsimore si më poshtë:
   - *Shkolla "Arben Broci"*
   - *Shkolla "Lasgush Poradeci"*
   - *Kopështi Nr.36*

5. Efektet financiare të pikës 1 të këtij Vendimi të përballohen duke pakësuar fondin e shpenzimeve operative nga transferta e pakushtëzuar e Drejtorisë së Konvikteve të Shkollave të Mesme në shumën 1.090.000 lekë.

6. Efektet financiare të pikës 3 të këtij Vendimi të përballohen duke pakësuar fondin rezervë nga të ardhurat e Bashkisë së Tiranës për vitin 2005.

7. Efektet financiare të pikës 4 të këtij Vendimi të përballohen duke pakësuar fondet e kushtëzuara për investimet në arsim në shumën prej 14.568.536 lekësh.

8. Për zbatimin e këtij Vendimi ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme Ekonomike, Drejtoria e Shërbimeve dhe Burimeve Njerëzore, Drejtoria e Konvikteve të Shkollave të Mesme dhe Aparati i Bashkisë.

9. Ky Vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

K R Y E T A R I

LUAN SHAHOLLARI